



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 2049/ 32 prot.

Datë 05/03/2026

**V E N D I M**  
**Nr. 355/2026**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 05/03/2026, mori në shqyrtim çështjen me,

**Objekt:**

Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 261/2026, datë 16.02.2026 për procedurën e prokurimit *Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar*, me objekt *“Blerje kuti dhe dosje për ruajtje të përhershme”*, *Marrëveshje Kuadër me një operatorë ekonomikë, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara me afat 4 (katër) vjeçar* me Nr. REF-43560-04-03-2025, me fond limit: 74,439,074 (shtatëdhjetë e katër milion e katërqindë e tridhjetë e nëntë mijë e shtatëdhjetë e katër) lekë pa TVSH ose 748,658.1 (shtatëqind e dyzet e tetë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e tetë pikë një) euro pa TVSH, kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë datë 03.04.2025 është 99.43 lekë, zhvilluar në datën 23.06.2025 nga autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.

**Ankimues:**

Operatori ekonomik *“Dynamicx Group”* SHPK me NIPT L42306022T, me adresa: Zona Kadastrale 3183, Nr. Pasurie 30/13, Krujë.

Bashkimi i operatorëve ekonomikë *“Office Paper”* SHPK & *“Inpress”* SHPK me NIPT L01524018M me adresa: Lagjia *“Qafe Kasha”*, Ndertese Private Nr. 5, Autostrada Tiranë - Durrës, km 6, Tiranë.

Operatori ekonomik “*Kristalina KH*” SHPK me NIPT K11501002D me adresa: Pasuria nr 178, Shargë, Tiranë.

Operatori ekonomik “*Marketing & Distribution*” SHPK me NIPT J72124001N me adresa: Autostrada Tirane - Durres, Km. 10, Tiranë.

Operatori ekonomik “*Adel Co*” SHPK me NIPT L22117021M me adresa: Rruga “Efendiu”, Nr. 13, Kodi 1050, Tiranë.

**Autoriteti Kontraktor:** Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.  
Adresa: Rruga “Reshit Çollaku”, Godina Nr.6/337, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë), Tiranë.

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID - 19*”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

## **Vëren:**

### **I**

#### *Rrethanat e çështjes*

I.1. Në datë 16.02.2026, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 261/2026, ku vendosi:

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “*Dynamicx Group*” SHPK, për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar*”, me objekt “*Blerje kuti dhe dosje për ruajtje të përhershme*”, Marrëveshje Kuadër me një operatorë ekonomikë, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara me afat 4 (katër) vjeçar” me Nr. REF-43560-04-03-2025, me fond limit: 74,439,074 (shtatëdhjetë e katër milion e katërqindë e tridhjetë e nëntë mijë e shtatëdhjetë e katër) lekë pa TVSH ose 748,658.1 (shtatëqind e dyzet e tetë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e tetë pikë një) euro pa TVSH, kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë datë 03.04.2025 është 99.43 lekë, zhvilluar në datën 23.06.2025 nga autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.

2. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Office Paper” SHPK & “Inpress” SHPK, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me objekt “Blerje kuti dhe dosje për ruajtje të përhershme”, Marrëveshje Kuadër me një operatorë ekonomikë, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara me afat 4 (katër) vjeçar” me Nr. REF-43560-04-03-2025, me fond limit: 74,439,074 (shtatëdhjetë e katër milion e katërqindë e tridhjetë e nëntë mijë e shtatëdhjetë e katër) lekë pa TVSH ose 748,658.1 (shtatëqind e dyzet e tetë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e tetë pikë një) euro pa TVSH, kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë datë 03.04.2025 është 99.43 lekë, zhvilluar në datën 23.06.2025 nga autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.
3. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Marketing & Distribution” SHPK, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me objekt “Blerje kuti dhe dosje për ruajtje të përhershme”, Marrëveshje Kuadër me një operatorë ekonomikë, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara me afat 4 (katër) vjeçar” me Nr. REF-43560-04-03-2025, me fond limit: 74,439,074 (shtatëdhjetë e katër milion e katërqindë e tridhjetë e nëntë mijë e shtatëdhjetë e katër) lekë pa TVSH ose 748,658.1 (shtatëqind e dyzet e tetë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e tetë pikë një) euro pa TVSH, kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë datë 03.04.2025 është 99.43 lekë, zhvilluar në datën 23.06.2025 nga autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.
4. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Kristalina KH” SHPK, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me objekt “Blerje kuti dhe dosje për ruajtje të përhershme”, Marrëveshje Kuadër me një operatorë ekonomikë, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara me afat 4 (katër) vjeçar” me Nr. REF-43560-04-03-2025, me fond limit: 74,439,074 (shtatëdhjetë e katër milion e katërqindë e tridhjetë e nëntë mijë e shtatëdhjetë e katër) lekë pa TVSH ose 748,658.1 (shtatëqind e dyzet e tetë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e tetë pikë një) euro pa TVSH, kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë datë 03.04.2025 është 99.43 lekë, zhvilluar në datën 23.06.2025 nga autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.
5. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Adel Co” SHPK, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me objekt “Blerje kuti dhe dosje për ruajtje të përhershme”, Marrëveshje Kuadër me një operatorë ekonomikë, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara me afat 4 (katër) vjeçar” me Nr. REF-43560-04-03-2025, me fond limit: 74,439,074 (shtatëdhjetë e katër milion e katërqindë e tridhjetë e nëntë mijë e shtatëdhjetë e katër) lekë pa TVSH ose 748,658.1 (shtatëqind e dyzet e tetë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e tetë pikë një) euro pa TVSH, kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë datë 03.04.2025 është 99.43 lekë, zhvilluar në datën 23.06.2025 nga autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.

6. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së, për kualifikimin e operatorit ekonomik “*Marketing & Distribution*” SHPK dhe të korrigojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke e skualifikuar këtë operator ekonomik.
7. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
8. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “*Kristalina KH*” SHPK, “*Dynamicx Group*” SHPK, “*Marketing & Distribution*” SHPK dhe “*Adel Co*” SHPK.
9. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “*Office Paper*” SHPK & “*Inpress*” SHPK.
10. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
11. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.  
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën nr. 2577/16 prot, datë 02.03.2026, me objekt “Mbi zbatimin e vendimit nr. 261/2026, datë 16.02.2026” protokolluar me tonën me nr. 2049/28 prot, datë 04.03.2026, autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a, ka informuar Komisionin e Prokurimit Publik mbi zbatimin e vendimit KPP 261/2026, për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar*”, me objekt “*Blerje kuti dhe dosje për ruajtje të përhershme*”, *Marrëveshje Kuadër me një operatorë ekonomikë, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara me afat 4 (katër) vjeçar*” me Nr. REF-43560-04-03-2025, me fond limit: 74,439,074 (shtatëdhjetë e katër milion e katërqindë e tridhjetë e nëntë mijë e shtatëdhjetë e katër) lekë pa TVSH ose 748,658.1 (shtatëqind e dyzet e tetë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e tetë pikë një) euro pa TVSH, kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë datë 03.04.2025 është 99.43 lekë, zhvilluar në datën 23.06.2025 nga autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.

## II

### Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

#### Arsyeton

II.1. Me shkresën nr. 2577/16 prot, datë 02.03.2026, me objekt “Mbi zbatimin e vendimit nr. 261/2026, datë 16.02.2026” protokolluar me tonën me nr. 2049/28 prot, datë 04.03.2026, autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a, ka informuar Komisionin e Prokurimit Publik mbi zbatimin e vendimit KPP 261/2026, për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar*”, me objekt “*Blerje kuti dhe dosje për ruajtje të përhershme*”, *Marrëveshje Kuadër me një operatorë ekonomikë, ku të gjitha kushtet janë të*

*përcaktuara me afat 4 (katër) vjeçar” me Nr. REF-43560-04-03-2025, me fond limit: 74,439,074 (shtatëdhjetë e katër milion e katërqindë e tridhjetë e nëntë mijë e shtatëdhjetë e katër) lekë pa TVSH ose 748,658.1 (shtatëqind e dyzet e tetë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e tetë pikë një) euro pa TVSH, kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë datë 03.04.2025 është 99.43 lekë, zhvilluar në datën 23.06.2025 nga autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.*

Referuar shkresës së mësipërme, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor, Komisioni vëren se, autoriteti kontraktor nëpërmjetë shkresës së mësipërcituar ka dërguar pranë Komisionit Prokurimit Publik praktikën për zbatimin e vendimit nr. 261/2026 datë 16.02.2026, të KPP. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik dhe raport auditit KPP konstaton se autoriteti kontraktor ka kryer rivlersimin e procedurës në zbatim të përcaktimeve të bëra në vendimin KPP 261/2026, datë 16.02.2026 për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

Përsa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

#### **Vendos**

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me objekt “Blerje kuti dhe dosje për ruajtje të përhershme”, Marrëveshje Kuadër me një operatorë ekonomikë, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara me afat 4 (katër) vjeçar” me Nr. REF-43560-04-03-2025, me fond limit: 74,439,074 (shtatëdhjetë e katër milion e katërqindë e tridhjetë e nëntë mijë e shtatëdhjetë e katër) lekë pa TVSH ose 748,658.1 (shtatëqind e dyzet e tetë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e tetë pikë një) euro pa TVSH, kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë datë 03.04.2025 është 99.43 lekë, zhvilluar në datën 23.06.2025 nga autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Gjergj Mersini**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

